

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Albert Zogaj, kryetar i kolegjit, Nora Bllaca Dula dhe Qerim Ademaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit XH.B. nga fshati ..., Komuna e Shtimes, të cilin e përfaqëson i autorizuari Z.I., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Illyria", në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari A.L., jurist pranë të paditurës, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesave së të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të të paditurës, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1895/10, i datës 08.09.2014, në seancën jo publike të mbajtur me datë 29.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN të pabazuara ankesat e të autorizuarit të paditësit XH.B. nga fshati ..., Komuna e Shtimes, dhe e të autorizuarit të të paditurës Kompania e Sigurimeve "Illyria", në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1895/10, i datës 08.09.2014, VËRTETOHEN, përveç në pjesën që ka të bëjë me kamatën në të cilën pjesë NDRYSHOHET dhe vendoset ashtu që: DETYROHET e paditura që paditësit t'i paguajë kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për një vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 08.09.2014, e deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.1895/10, i datës 08.09.2014, në pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses XH.B. nga fshati ..., Komuna e Shtimes, dhe e ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve "Illyria", në Prishtinë, që paditësit në emër të dëmit jo material, të shkaktuar si pasojë e lëndimeve të marra në aksidentin e komunikacionit të datës 18.07.2010, nga baza e autopërgjegjësisë, për 80% të përgjegjësisë, t'ia paguaj shumat si vijon: në emër të dhimbjeve trupor-fizike, shumën prej 2.000 Euro, në emër të frikës së pësuar, shumën prej 1.500 Euro, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 3.000 Euro.

Në pikën II (dy) të dispozitivit e ka detyruar të paditurën të paguaj shumat e cekura në pikën I të dispozitivit ashtu që shuma e tërësishme arrin vlerën prej 6.500 Euro, kamatën vjetore prej 3.5%, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit 08.09.2014, për pjesën e gjykuar të kompensimit, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 645 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Në pikën III (tre) të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar pjesën e kërkesëpadisë së paditësit, mbi shumat e gjykuara, dhe atë në emër të kompensimit të dëmit jo material, në emër të dhimbjeve trupore-fizike, shumën prej 400 Euro, për frikën e përjetuar, shumën prej 900 Euro, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshme jetësor, shumën prej 200 Euro, ndërsa në tërësi e ka refuzuar kërkesa për kompensim të dëmit material dhe atë në emër të shpenzimeve të ndihmës së personit tjetër, në shumën prej 80.00 Euro, në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 25.00 Euro, dhe në emër të shpenzimeve materiale gjatë kohës së shërimit, shumën prej 80 Euro.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor kanë paraqitur ankesë i autorizuari i paditësit dhe i autorizuari i të paditurës. I autorizuari i paditësit ka paraqitur ankesë për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ashtu që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit.

I autorizuari i të paditurës ka paraqitur ankesë për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim bërë gjykatës ankimore që të aprovohet si e bazuar ankesa, ndërsa aktgjykimi i atakuar në pikën I të ndryshohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të autorizuarit të paditësit, dhe e të autorizuarit të të paditurës janë të pabazuar përveç në pjesën e kërkesëpadisë lidhur me kamatën.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi XH.B. nga fshati ..., Komuna e Shtimes, me datë 31.08.2010, përmes të autorizuarit të tij ka ushtruar padi për kompensimin e dëmit material dhe jo material në gjykatën e shkallë së parë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Illyria", në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo-material, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 8.185,00 Euro, me kamatë siç paguan banka për mjetet pa destinacion të caktuar, të afatizuara mbi 12 muaj, duke filluar nga data e gjykimit gjer në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të provave dhe të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.1895/10, i datës 08.09.2014, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimit të njëjtë.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se me datë 18.07.2010, rreth orës 20:20, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit në Rr. "Tirana", në Shtime, dhe se deri te ky aksident ka ardhur kur këtu i padituri me veturën tipi "Kombi VW", i siguruar tek e paditura, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes, kushteve të rrugës, me pjesën e parë të anës së djathtë e godet këmbësorin këtu paditësin i cili ishte duke e kaluar rrugën nga ana e djathtë në të majtë të drejtimit të lëvizjes së automjetit, me ç'rast paditësi pëson lëndime, i cili menjëherë është dërguar në emergjencën e Shtimes, dhe më pas në QKUK.

Përgjegjësinë e të paditurës gjykata e ka vërtetuar me ekspertizën e komunikacionit të muajit qershor 2014, sipas të cilës ka vërtetuar se deri te aksidenti në fjalë ka ardhur si pasojë e lëshimeve primare të vozitësit të automjetit "A" (Volskwagen Kombi), me targa XYZKS-XYZ, me veprimet e tij, si tejkalim i shpejtësisë së lejuar, respektivisht mospërshtatje e shpejtësisë së lëvizjes së kushteve të rrugës në vendbanim, si dhe moskujdes ndaj këmbësorit, me ç'rast ka përgjegjësi të ndarë, andaj gjykata ka ardhur në përfundim se 80% është faji i të siguararit të të paditurës, ndërsa 20% i paditësit.

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë gjykata në procedurën e provave ka nxjerrë ekspertizën mjekoligjore të punuar nga Dr.A.T.-traumatolog, dhe Dr.F.D.-neupsikiatër, në bazë të së cilës është vërtetuar se paditësi ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 20 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 48 orë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm 21 ditë, dhimbje fizike të intensitetit të ulët gjashtë muaj. Frika primare disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë 14 ditë, frikë sekondare të intensitetit të ulët 5 muaj, ndërsa zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor tek paditësi është në shkallë prej 10 % .

Gjykata ka arsyetuar se ka vlerësuar së shpërblimi i drejtë për paditësin përkitazi me dhimbjet fizike është në lartësi prej 2000 Euro, pasi që mori për bazë natyrën e lëndimit, pasojat dhe intensitetin e dhimbjeve, si dhe faktin se edhe paditësi ka kontribuar në aksident me 20%. Lidhur me lartësinë e gjykuar për frikën gjykata ka arsyetuara se ka vlerësuar se kompensimi i drejtë është në shumë prej 1500 Euro, pasi që mori për bazë llojin, intensitetin, kohëzgjatjen dhe mënyrë e manifestimit të frikës tek paditësi.

Përfundimin e saj për përgjegjësinë e të paditurës që t'i kompenzon dëmin paditësit gjykata e shkallë së parë e ka bazuar në dispozitat nga neni 178 al 1 dhe 154 të LMD-së, ndërsa për llojet apo format e dëmit për të cilat është pranuar kompensimi gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave nga neni 200 i LMD-së.

Për të gjitha kategoritë e dëmit jo material gjykata ka shtuar se duke u bazuar në dispozitat e cituara dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret edhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jo material, posaçërisht duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuara paditësit, në bazë të vlerësimit të ekspertizës mjekësore, gjykata duke ju referuar edhe ndarjes së përgjegjësisë ka vendosur për aprovimin e pjesshëm të kërkesëpadisë.

Lidhur me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që i referohet dëmit jo material gjykata ka theksuar se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë.

Për kamatën ka vendosur në kuptim të nenit 277 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurën në kuptim të dispozitave të nenit 449 dhe 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë përveç në pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me kamatën, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Palët ndërgjyqësore me ankesat e tyre nuk kanë paraqitur pretendime për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, prandaj gjykata ankimore është kufizuar vetëm në shqyrtimin e shkeljeve të cilat shikohen sipas detyrës zyrtare, për të cilat ka gjetur se aktgjykimi nuk është i përfshirë, e gjithashtu palët nuk kanë paraqitur pretendime ankimore as për gjendjen faktike.

Përkitazi me të drejtën materiale të zbatuar nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Apelit vlerëson se nga të gjeturat faktike të vërtetuara me provat e administruara në këtë çështje juridike kontestuese, gjykata e shkallës së parë drejtë ka bërë kualifikimin e fakteve në pajtim me normat materialo-juridike të zbatuara në këtë rast me referencë në dispozitat e nenit 154 dhe 178.2 të LMD-së, lidhur me përgjegjësinë dhe ndarjen e përgjegjësisë. Është i drejtë zbatimi i dispozitave të sipërcituara sepse me dispozitën e nenit 154 paragrafi 1 i LMD-së, përcaktohet baza e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit, ndërsa me dispozitën e nenit 178.2 të LMD-së, përcaktohet ndarja e përgjegjësisë sipas kontributit në shkaktimin aksidentit.

Sa i përket formave të dëmit jo material dhe lartësisë së gjykuar sipas vlerësimit të gjykatës ankimore, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me referencë në dispozitat e nenit 200 të LMD-së, me ç'rast ka marrë për bazë natyrën e lëndimeve të kualifikuar si lëndime të lehta trupore por më pasoja për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 10%, si dhe dhimbje dhe frikë e manifestuar si në përshkrimin me lartë. Në këtë rast gjykata ankimore vlerëson se gjykata e shkallës së parë duke marrë për bazë pasojat e lëndimeve të manifestuara tek paditësi në formë të dhimbjeve fizike, frikës dhe zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, ka gjykuar kompensimin në mënyrë të drejtë dhe ligjore duke siguruar që kompensimi të jetë një lloj satisfaksioni për paditësin me qëllim të përpjekjes për të zbutur pasojat negative që janë shfaqur tek paditësi si pasojë e cenimit të integritetit të tij fizik dhe psikik. Shumat e gjykuara janë në harmoni edhe me praktikën e mirë gjyqësore për këto forma të dëmit jo material dhe në këtë kontekst përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është në tërësi i pranuar nga gjykata ankimore.

Pjesa e refuzuar e kërkesëpadisë është përfundim i drejtë sepse kompensimi për tej të shumave të gjykuara nuk do të ishte në harmoni me të mirën e cenuar dhe qëllimin e kompensimit, ndërsa për dëmin material pala paditëse nuk ka paraqitur pretendim ankimor, prandaj gjykata ankimore e ka vërtetuar aktgjykimin edhe në pjesën e refuzimit të kërkesëpadisë për dëmin material.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar sa i përket kamatës, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, meqenëse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar.

Në këtë rast është zbatuar në mënyrë të gabuar dispozita e nenit 277 e LMD-së, pasi që kamata nuk është përcaktuar në përputhshmëri me këtë dispozitë.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës Gjykata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të duhur sepse i ka arsyetuar shpenzimet e gjykuara për secilin veprim të ndërmarrë në procedurën kontestimore, e të cilat veprime edhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit kanë qenë të domosdoshme në mënyrë që gjykata e shkallës së parë të vendosë për themelësinë e kërkesëpadisë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e), 200 dhe 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4781/14, me datë 29.10.2018

Kryetari i kolegjit
Albert Zogaj, d.v